

# **Banka e Shqipërisë**

## **Buletini i Bilancit të Pagesave**

### **Botim Tremujor**

**Qershor 2002**

## 1. PAMJE E PËRGJITHSHME

Treguesit e bilancit të pagesave për tremujorin e dytë të vitit 2002 reflektojnë një aktivitet mjaft intensiv të sektorit të jashtëm të shprehur në rritjen e konsiderueshme të të ardhurave e shpenzimeve korente dhe flukseve të kapitalit. Llogaria korente në fund të tremujorit u mbyll me një deficit prej 156.7 milionë dollarësh, i cili është shkaktuar kryesisht nga rritja e deficitit tregtar të mallrave. Ky deficit është financuar me rreth 58 për qind prej flukseve hyrëse të kapitaleve, bilanci pozitiv i të cilave, në fund të periudhës, vlerësohet me rreth 91 milionë dollarë. Pjesa e mbetur e deficitit korent është financuar nga transaksione të tjera të paidentifikuara, të cilat reflektohen në zërin Gabime dhe Harresa<sup>1</sup>. Rezervat e autoritetit monetar janë rritur me rreth 1 milion dollarë.

**Tabelë 1. BILANCI I PAGESAVE GJATË VITEVE (në mln usd).**

	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	3M-II '01	3M-II '02
<b>LLogaria Korrente</b>	<b>31.4</b>	<b>36.6</b>	<b>-62.3</b>	<b>-253.7</b>	<b>-65.0</b>	<b>-132.9</b>	<b>-163.1</b>	<b>-217.9</b>	<b>-94.3</b>	<b>-156.7</b>
Eksporti i mallrave fob	141.4	204.8	243.7	158.6	208.0	275.1	255.4	304.6	87.8	72.1
Importi i mallrave fob	-601.0	-679.8	-922.0	-693.5	-811.7	-937.9	-1,076.4	-1,331.6	-328.1	-360.1
Bilanci tregtar	-459.6	-475.0	-678.3	-534.9	-603.6	-662.8	-821.0	-1,027.0	-240.3	-288.0
Shërbimet: Kredi	83.1	98.2	127.3	67.9	86.6	266.7	448.1	533.5	108.2	119.1
Shërbimet: Debi	-97.5	-106.3	-142.3	-101.1	-129.3	-165.4	-430.0	-444.2	-103.6	-147.9
Të ardhurat: Kredi	55.6	70.8	83.5	61.6	86.1	85.6	115.9	162.5	39.2	35.6
Të ardhurat: Debi	-41.4	-28.5	-12.0	-11.9	-8.7	-10.3	-9.1	-13.4	-2.0	-9.4
Transferrat private	374.1	348.9	476.0	235.7	421.3	188.4	438.6	542.6	97.2	124.1
Transferrat shtetërore	117.1	128.5	83.4	29.0	82.6	165.0	94.4	28.1	7.0	9.7
<b>Llogaria kapitale</b>	<b>21.6</b>	<b>389.5</b>	<b>4.9</b>	<b>2.1</b>	<b>31.1</b>	<b>67.5</b>	<b>78.2</b>	<b>117.8</b>	<b>31.3</b>	<b>37.5</b>
<b>Llogaria financiare</b>	<b>24.2</b>	<b>-414.5</b>	<b>49.6</b>	<b>140.7</b>	<b>16.0</b>	<b>36.8</b>	<b>182.5</b>	<b>109.0</b>	<b>51.7</b>	<b>53.6</b>
Investime direkte	53.0	70.0	90.1	47.5	45.0	41.2	143.0	207.3	34.1	29.0
Investime portofoli	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-25.0	-23.4	-6.3	-10.2
Kapitale të tjera	-28.7	-484.5	-40.5	93.2	-29.0	-4.4	64.5	-86.9	23.9	34.8
Gabime dhe harresa	-44.5	7.9	54.8	142.5	69.4	131.3	15.0	136.1	26.5	66.5
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>54.9</b>	<b>30.6</b>	<b>47.0</b>	<b>43.8</b>	<b>59.4</b>	<b>123.5</b>	<b>131.9</b>	<b>145.0</b>	<b>15.3</b>	<b>0.9</b>
Rezerva & zëra të lidhur me të										
Mjetet e rezervës	-54.9	-30.6	-47.0	-43.8	-59.9	-123.6	-131.9	-145.0	-15.3	-0.9
Përdor. kred. & huash nga fondi	22.2	11.1	0.0	12.2	7.9	20.9	19.3	12.0	0.0	0.0
Det. ndaj Auto. Monet. të Huaja	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...
Financime të jashtëzakonshme	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...
<b>Për t'u përmendur</b>										
Ndryshim i Rezervave	-54.8	-30.6	-39.5	-28.3	-75.9	-97.4	-130.5	-116.2	-12.7	-42.7
Efekti nga Kursi i Këmbimit	7.3	5.1	-7.3	-15.5	12.6	-26.2	-3.5	1.5	-12.0	47.3

Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë.

<sup>1</sup> Në mungesë të statistikave nga burimet zyrtare, statistikave të bilancit të pagesave në disa shifra përmbajnë vlerësime të Bankës së Shqipërisë, për rrjedhim ajo rezervon të drejtën të revizionojë këto statistika kur të dhënat zyrtare të bëhen të vlefshme.

Transaksionet e tregtisë së jashtme<sup>2</sup> llogariten në rreth 432 milionë dollarë dhe përfaqësojnë në masën 49 për qind volumin e transaksioneve korente. Tregtia në mallra vlerësohet në rritje si ndaj tremujorit paraardhës ashtu edhe krahasuar me periudhën korresponduese në vitin paraardhës, përkatësisht me 10 dhe 4 për qind.

Ashtu si në periudhat e mëparshme edhe këtë periudhë, në peshë të konsiderueshme, fluksi tregtar në mallra përfaqësohet nga importi (rreth 83 për qind), gjë që flet për një ekonomi dhe treg të brendshëm të orientuar nga importi.

Importi i mallrave kapi shifrën 360 milionë dollarë dhe vlerësohet në rritje si ndaj tremujorit paraardhës ashtu edhe përkundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, përkatësisht 14 dhe 10 për qind, duke mbetur faktori i vetëm që çoi në rritje të volumit të tregtisë ndërkohë që, eksporti paraqitet në rënie.

Ecuria e eksporteve paraqitet e përkeqësuar. Volumi i eksporteve ra në 72 milionë dollarë, nga 88 milionë në periudhën prill-qershor 2001. Tendencat në rënie shfaqën si eksportet nga prodhimi i brendshëm ashtu edhe riekportet (prodhim mall i porositur) duke ndikuar negativisht në ecurinë e të ardhurave nga eksporti i mallrave për këtë tremujor.

Tendencat e mësipërme të vërejtura në sjelljen e komponentëve tregtarë shkaktuan thellimin e deficitit tregtar. Këtë tremujor, borxhi tregtar vlerësohet në 288 milionë dollarë dhe mban një nivel 20 për qind më të lartë se në periudhën korresponduese të vitit parardhës.


Zhvillimet në tregtinë e shërbimeve për këtë tremujor evidentojnë një rritje konsiderueshme të shpenzimeve kundrejt të ardhurave, duke çuar kështu bilancin e shërbimeve në deficit (rreth 29 milionë dollarë). Edhe këtë tremujor turizmi është komponenti kryesor në bilacin e shërbimeve. Kështu, shpenzimet dhe të ardhurat e turizmit zënë rreth 62 dhe 79 për qind të importit dhe eksportit të shërbimeve.

---

<sup>2</sup> Llogaritur sipas metodikës së BP, importi në çmim F.O.B.

Bilanci pozitiv i transaksioneve të “të ardhurave” regjistroi rreth 26 milionë dollarë. Ky suficit është mundësuar kryesisht prej të ardhurave nga puna e punëtorëve sezonalë si dhe nga investimet e mjeteve valutore të sistemit bankar. Megjithatë, krahasuar me periudhën paraardhëse ky suficit vlerësohet në rënie me 8 për qind. Rënia e këtij suficiti ka të bëjë me rritjen e të ardhurave dalëse në formën e pagesave të interesave të maturuar të borxhit të jashtëm, të cilat regjistruan shifrën 8.6 milionë dollarë.

**Grafik 1. LLOGARITË E BILANCIT TË PAGESAVE.**



Këtë tremujor, rreth 43 për qind e deficitit tregtar është financuar nga dërgesat e emigrantëve, të cilat vlerësohen rreth 124 milionë dollarë. Transfertat shtetërore vlerësohen rreth 9.7 milionë dollarë. Këto transferta janë kryesisht në formën e asistencës teknike.


Flukset neto të kapitalit këtë tremujor regjistruan rreth 91 milionë dollarë. Pas kësaj shifre pozitive, qëndrojnë transfertat kapitale prej rreth 37 milionë dollarësh dhe bilanci pozitiv i llogarisë financiare prej rreth 54 milionë dollarësh.

## LLOGARIA KORENTE

Transaksionet korente (880 milionë dollarë) në fund të tremujorit të dytë vlerësohen të rritura me rreth 5.1 dhe 9.5 për qind respektivisht kundrejt tremujorit paraardhës dhe të njëjtës periudhë të vitit 2001. Kjo rritje i dedikohet shpenzimeve korente, ku rreth 69 për qind e zë importi i mallrave.

Të ardhurat korente regjistruan 361 milionë dollarë dhe vlerësohen në rënie, prej rreth 8 për qind, kundrejt tremujorit paraardhës dhe në rritje rreth 2 për qind ndaj tremujorit të dytë të vitit të kaluar.

**Grafik 2. LLOGARIA KORENTE DHE BILANCI FISKAL.**




Shpenzimet korente (rreth 518 milionë dollarë) vlerësohen me një rritje prej 15.5 për qind kundrejt tremujorit korrespondues një vit më parë dhe 17 për qind kundrejt tremujorit paraardhës.

Në rritjen e këtyre shpenzimeve kanë ndikuar kryesisht importet e larta të mallrave dhe shërbimeve të cilat kanë çuar në një deficitit korent të lartë prej 156.7 milionë dollarësh. Ky deficit paraqitet i rritur si kundrejt periudhës paraardhëse ashtu edhe asaj korresponduese një vit më parë, respektivisht me 3 dhe 1.7 herë.

## 2.1 TREGTIA E JASHTME

Të dhënat mbi transaksionet e tregtisë së jashtme, të zhvilluara gjatë tremujorit të dytë të vitit 2002, flasin për rritje të aktivitetit tregtar të Shqipërisë me botën. I vlerësuar në rreth 432 milionë dollarë, volumi i përgjithshëm tregtar u rrit me 4 për qind krahasuar me periudhën korresponduese në vitin paraardhës. Intensifikimi i shkëmbimeve tregtare me botën vërehet vetëm në krahun e importit; shpenzimet në importin e mallrave u rritën me 10 për qind, ndërkohë që, të ardhurat nga eksporti u vlerësuan në rënie, rreth 18 për qind.

**Grafik 3. BILANCI TREGTAR (në mln usd).**



Tendenca në rritje e importit flet për rritje të kërkesës së brendshme për mallra importi. Kjo u shpreh me volume në rritje të importeve për konsum, investime dhe të importeve lëndë e parë për industrinë e përpunimit aktiv në vend, kundrejt të njëjtës periudhë në vitin paraardhës.

Importet ndihma vlerësohen rreth 17 për qind më të larta, kundrejt një viti më parë. Ndihamat në mallra ishin kryesisht në mallra ushqimorë dhe në makineri e pajisje, me donatorë kryesorë Greqinë, Italinë dhe Amerikën.

Nën këto tendenca importi i mallrave hyri në një volum prej 360 milionë dollarë dhe përfaqëson 83 për qind të volumit tregtar të realizuar përgjatë tremujorit.

**Tabelë 2. TREGTIA E JASHTME SIPAS TREMUJORËVE PËR PERIUDHËN '94-'01 (në mln usd).**

Periudha	Eksporte	Ndryshimi në % ndaj periudhës paraardhëse	Importe	Ndryshimi në % ndaj periudhës paraardhëse
T1 1994	28.0	-19.7	-98.6	-29.7
T2 1994	31.2	10.0	-136.9	22.1
T3 1994	30.9	0.6	-148.2	4.0
T4 1994	51.8	67.5	-171.6	12.8
T1 1995	42.0	-19.0	-163.5	-6.5
T2 1995	51.1	21.8	-177.0	8.2
T3 1995	57.3	12.0	-150.4	-15.0
T4 1995	54.5	-4.8	-188.8	25.5
T1 1996	68.0	24.8	-208.4	10.3
T2 1996	57.1	-16.0	-209.6	0.6
T3 1996	56.5	-1.1	-225.2	7.4
T4 1996	62.1	9.9	-278.8	23.8
T1 1997	34.2	-44.8	-143.9	-48.4
T2 1997	42.2	23.2	-114.5	-20.4
T3 1997	41.3	-2.1	-171.1	49.3
T4 1997	40.9	-0.9	-264.0	54.3
T1 1998	42.2	3.2	-176.8	-33.0
T2 1998	49.3	16.8	-198.1	12.1
T3 1998	53.0	7.5	-196.1	-1.0
T4 1998	63.4	19.6	-240.6	22.7
T1 1999	72.9	15.0	-185.6	-22.9
T2 1999	78.4	7.5	-250.1	34.8
T3 1999	58.6	-25.2	-252.1	0.8
T4 1999	65.1	11.1	-250.1	-0.8
T1 2000	61.7	-5.4	-227.3	-9.1
T2 2000	68.5	11.2	-257.3	13.2
T3 2000	63.5	-7.3	-261.1	1.5
T4 2000	62.2	-2.1	-324.3	24.2
T1 2001	78.5	26.2	-285.4	-12.0
T2 2001	87.8	11.9	-328.1	15.0
T3 2001	58.5	-33.4	-317.7	-3.2
T4 2001	79.8	36.5	-400.3	26.0
T1 2002	76.0	-4.8	-315.8	-21.1
T2 2002	72.1	-5.1	-360.1	14.0

Ecuria në eksporte paraqitet e përkeqësuar. I vlerësuar në rreth 72 milionë dollarë eksporti i mallrave, regjistroi rënie si kundrejt periudhës paraardhëse ashtu edhe krahasuar me periudhën korresponduese të një viti më parë, përkatësisht 5 dhe 18 për qind.

Rënia e eksporteve ndërkohë kur pritej një rigjallërim i tyre tregon se potencialet e ekonomisë për eksport nuk po arrihet të shfrytëzohen. Një nga shumë arsyet e

përkeqësimit të eksporteve është gjendja në pritje për privatizimin e industrisë minerale, e cila tradicionalisht ka përbërë një zë shumë të rëndësishëm të eksportit shqiptar. Kjo pritje ka ulur në minimum prodhimin e minierave të cilat zakonisht eksportohen.

Gjithashtu, situata e vështirë energjitike në vend mendohet të ketë patur ndikime negative në realizimin e eksporteve nga industria e lehtë (këpucë dhe tekstile të prodhuara me porosi), të cilat përfaqësojnë mëse 2/3 e të ardhurave nga eksporti.

Tendenca në rritje e importit në një kohë kur eksporti paraqitet i dobët dhe në rënie çoi në thellimin e borxhit tregtar, i cili u vlerësua 20 për qind më i lartë se në periudhën korresponduese të vitit paraardhës. Deficiti tregtar është i pranishëm përgjatë gjithë grupmallrave me përjashtim të grupit veshje të këmbëve, në të cilin vlera e shtuar në rieksperte bën që ky grupmall të regjistrojë vazhdimisht suficit. Importet e larta në mallra ushqimorë, produkte minerale dhe metale bazë cilësohen si faktorët që shkaktuan, në masën më të madhe, thellimin e deficitit tregtar.

### **2.1.1 Struktura në eksporte dhe importe sipas përpunimit aktiv**

Aktiviteti tregtar në fushën e përpunimit aktiv përfaqëson një pjesë të rëndësishme në shkëmbimet tregtare të Shqipërisë me botën. E vlerësuar në rreth 117 milionë dollarë, tregtia nga industria e përpunimit aktiv në vend përfaqësoi rreth 27 për qind të shkëmbimeve tregtare të zhvilluara gjatë këtij tremujori. Industria e përpunimit aktiv përfaqëson përgjithësisht aktivitetin e subjekteve me kapital të huaj organizuar në kompani të vogla dhe të mesme. Kjo industri është e përqendruar kryesisht në përpunimin e mallrave tekstilë, veshje këmbësh dhe lëkurë, të cilat së bashku zënë rreth 82 për qind në shkëmbimet tregtare të kryera prej saj. Italia mbetet investitori kryesor në fushën e përpunimit aktiv në vend i ndjekur nga Greqia.




**Importi** i mallrave lëndë e parë për produkte eksporti (prodhim mall me porosi) përfaqësoi në masën 18 për qind shpenzimet e importit të mallrave, përgjatë këtij tremujori, dhe vlerësohet në rritje si ndaj periudhës paraardhëse ashtu edhe krahasuar me tremujorin e dytë në vitin 2001 (shih tabela). Me volume në rritje kanë ardhur importet në tekstile, veshje këmbësh dhe lëkurë, të cilat kryesojnë importet lëndë e parë për industrinë e përpunimit në vend, duke zënë përkatësisht 45, 17 dhe 14 për qind të volumit të importuar.

TREGTIA	Volumi (në mln USD)			Pesha (%)			Ndryshimi (%)	
	T2 2001	T1 2002	T2 2002	T2 2001	T1 2002	T2 2002	T2 2002/T1 2002	T2 2002/T2 2001
<b>Totali i eksportit</b>	<b>87.8</b>	<b>76.0</b>	<b>72.1</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>-5.1</b>	<b>-17.9</b>
<i>nga të cilat:</i>								
Eksport i zakonshëm	26.2	16.7	19.4	29.8	22.0	26.9	15.8	-26.0
Rieksport nga përpunimi aktiv	61.7	59.3	52.7	70.2	78.0	73.1	-11.0	-14.5
<b>Totali i importit</b>	<b>329.5</b>	<b>319.7</b>	<b>364.1</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>13.9</b>	<b>10.5</b>
<i>nga të cilat:</i>								
Import i përkohshëm për përpunim aktiv	51.7	51.7	64.0	15.7	16.2	17.6	23.7	23.8
Importe ndihma	3.3	7.0	3.8	1.0	2.2	1.0	-45.9	16.6

**Rieksporti**, i cili, gjatë këtij tremujori, siguroi në masën 73 për qind të ardhurat në valutë të vendit nga tregtia e jashtme në mallra, vlerësohet në rënie (shih tabela). Sidoqoftë, pritshmëria në ecurinë e rieksporteve ishte më optimiste, por situata e vështirë energjitike në vend mendohet të ketë patur ndikime negative në realizimin e eksporteve të kësaj kategorie.

Rënie regjistruan eksportet në artikuj tekstilë e veshje këmbësh, nga të cilat sigurohet 88 për qind e të ardhurave nga industria e përpunimit aktiv në vend. Ndërkohë që, rieksporti në artikuj prej metali këtë tremujor regjistroi rritje krahasuar me periudhën korresponduese të një viti më parë.

**Grafik 4. TENDENCA NË ECURINË E TREGTISË NGA FUSHA E PËRPUNIMIT AKTIV, (indeks: T1 1996=100).**



Rritja e importeve lëndë e parë për industrinë e përpunimit aktiv në vend flet për vazhdimësi pozitive të saj, megjithë efektet e mundshme negative që rrjedhin nga problematika në furnizimin me energji elektrike në vend.

### 2.1.2 Importi dhe eksporti sipas grupmallrave

Importi tregtar<sup>3</sup> realizoi një volum prej 360 milionë dollarësh duke u vlerësuar në rritje si ndaj tremujorit të parë të vitit ashtu edhe krahasuar me periudhën korresponduese të vitit të kaluar, përkatësisht me 15 dhe 10 për qind.

Tendenca në rritje e importit flet për rritje të kërkesës së brendshme për mallra të importuar. Rritje të konsiderueshme, krahasuar me periudhën korresponduese në vitin e kaluar, regjistruan importet në produkte minerale, në metale bazë dhe në mallrat ushqimorë. Ndërkohë që, importi në produkte vegjetale dhe makineri e pajisje vlerësohet në rënie.

<sup>3</sup> Në analizën e mëposhtme importi nuk përmban vlerësime të bëra nga BP. Importi është i shprehur në vlerë C.I.F.

**Tabelë 3. IMPORTI SIPAS 21 GRUPMALLRAVE (në milionë usd).**

HS	GRUPMALLRA	Volumi (në mln USD)			Pesha (%)			Ndryshimi (%)	
		T2 2001	T1 2002	T2 2002	T2 2001	T1 2002	T2 2002	T2 2002/T1 2002	T2 2002/T2 2001
I	Kafshët e gjalla; Produktet me origjinë kafshore	6.8	9.1	10.4	2.1	2.9	2.9	14.7	53.7
II	Produktet vegjetale	25.9	28.7	23.2	7.9	9.2	6.4	-19.2	-10.3
III	Vajra dhe yndyra kafshore apo vegjetale	4.5	3.6	6.4	1.4	1.1	1.8	77.9	42.4
IV	Ushqime të përgatitura, pije alkoolike e uthull, duhan	26.0	26.9	31.6	8.0	8.6	8.8	17.7	21.8
V	Produkte minerale	41.1	43.2	50.1	12.6	13.8	13.9	15.9	22.0
VI	Produktet e industrisë kimike apo ind. të lidhjeve	19.3	19.6	20.6	5.9	6.3	5.7	4.9	6.5
VII	Plastikat; gomat dhe artikujt e tyre	9.0	8.1	9.7	2.7	2.6	2.7	20.4	8.5
VIII	Lëkurat e papërpunuara e të përpunuara, artikujt e tyre	6.0	7.5	9.0	1.9	2.4	2.5	19.5	48.2
IX	Druri, tapa art. e tyre; prodhime kashte, kallama	3.1	2.6	4.0	1.0	0.8	1.1	57.2	30.4
X	Brumi i drurit, mbetjet e letrës, letra, kartoni art. të tyre	5.6	6.1	8.0	1.7	2.0	2.2	30.6	42.0
XI	Tekstilët dhe artikujt tekstilë	34.7	33.2	38.6	10.6	10.6	10.7	16.4	11.2
XII	Veshjet e këmbëve, të kokës, cadrat, lule artificiale	12.2	12.9	13.8	3.7	4.1	3.8	7.1	12.9
XIII	Art. prej guri, allcie, cimentoje; qeramike; qelq	12.9	10.6	14.5	4.0	3.4	4.0	36.8	12.6
XIV	Perlat; gurë e metalet e çmuar; bizhuteri; monella	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	64.2	31.4
XV	Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	27.6	24.0	34.0	8.5	7.7	9.4	41.6	23.2
XVI	Makineri e pajisje mekanike, elektrike, pjesët e tyre	62.1	48.6	56.4	19.0	15.5	15.7	16.2	-9.1
XVII	Mjete transporti, avjone, anije, pajisje shoqëruese transp.	17.9	17.6	17.8	5.5	5.6	4.9	1.0	-0.7
XVIII	Instrumente e aparate optike; orë; instrum. muzikorë	3.5	3.7	2.6	1.1	1.2	0.7	-31.0	-26.2
XIX	Armët e municione; pjesët e plotësuesit e tyre	0.0	0.2	0.1	0.0	0.1	0.0	-44.9	194.6
XX	Artikujt të ndryshëm të prodhuar	7.9	6.4	8.8	2.4	2.0	2.4	37.3	11.5
XXI	Veprat e artit, copat e mbledhura nga antikikat	0.0	0.0	0.5	0.0	0.0	0.1	...	...
<b>TOTALI</b>		<b>326.2</b>	<b>312.7</b>	<b>360.3</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>15.2</b>	<b>10.4</b>

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë në vend, krijoi kushte të favorshme për shtimin e prodhimit bujqësor. Tregu vendas në perime ka qenë kryesisht i furnizuar nga prodhues shqiptarë<sup>4</sup>. Kjo ka çuar në rënie të importeve në produkte vegjetale. Megjithatë, agroindustria që përfaqëson produkte me peshë më të madhe në totalin e importeve ushqimore, ende paraqitet me deficit në sasi për furnizimin e tregut të brendshëm. Rrjedhimisht, kërkesa për importe në ushqim, pije, duhan mbeti e lartë. Ecuria e importeve, këtë tremujor, flet për rritje të kërkesës së brendshme në mallra ushqimorë duke çuar në rritje të shpenzimeve të importeve për këto produkte (përfshi këtu grupet nga I në IV të klasifikimit HS) me rreth 14 për qind krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2001.

Situata e vështirë energjitike në vend ka rritur importet në energji elektrike dhe në karburante për t'u përdorur si zëvendësues. Gjatë tremujorit të dytë të vitit janë importuar rreth 297 milionë KWH energji elektrike më shumë se në tremujorin e dytë të vitit 2001, duke çuar në rritje të shpenzimeve të importit të energjisë elektrike me rreth 55 për qind. Importi në karburante, i ardhur konsiderueshëm në rritje përgjatë gjysmës së dytë të vitit të kaluar dhe në tremujorin e parë të këtij viti, këtë tremujor u vlerësua në rënie ndaj periudhës paraardhëse.

Megjithatë, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2001 importi në karburante vlerësohet 8 për qind më i lartë. Gjithashtu, në rritje ka ardhur importi në çimento, 9 për qind më i lartë krahasuar me periudhën korresponduese në vitin e kaluar. Këto zhvillime çuan në rritje të shpenzimeve të importeve në produkte minerale.

Rritja në importet e produkteve të industrisë kimike, mund të jetë rezultat edhe i kërkesës së shtuar të prodhuesve bujqësorë për plehra kimike gjë që pritet të japë ndikim në zhvillimin e sektorit bujqësor.

Rritje regjistruan, gjithashtu, importet lëndë e parë për industrinë e përpunimit aktiv në vend (*fason*), të cilat vlerësohen 24 për qind më të larta krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2001.

Importet në makineri e pajisje, të cilat përgjatë vitit të kaluar u stimuluan nga hyrja në treg e operatorëve telefonikë AMC dhe Panafon Vodafon, këtë tremujor vlerësohen në rënie krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2001. Megjithatë, ato vlerësohen në rritje ndaj tremujorit paraardhës duke përfaqësuar rreth 16 për qind të shpenzimeve në importin e mallrave.

Eksporti i mallrave paraqitet nën tendenca negative zhvillimi duke u vlerësuar në rënie si ndaj tremujorit paraardhës ashtu edhe krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2001.

Tendenca në rënie shfaqën si eksportet nga prodhimi i brendshëm ashtu edhe riekportet (prodhim mall i porositur) duke ndikuar negativisht në ecurinë e të ardhurave nga eksporti i mallrave këtë tremujor.

Struktura e eksportit domimohet nga eksportet me material porositësi, *fason* (kryesisht këpucë dhe tekstile), të cilat përfaqësuan rreth 73 për qind të të ardhurave nga eksporti i mallrave, ndërkohë që, eksporti i prodhimeve vendase kontribuoi me 27 për qind të saj. Të dy këta komponentë vlerësohen në rënie kundrejt një viti më parë: eksporti nga prodhimi i brendshëm ra rreth 26 për qind dhe eksporti nga industria e përpunimit me material porositësi regjistroi një nivel 15 për qind më të ulët.

---

<sup>4</sup> Nga inspektimet e bëra nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Eksporti i nga prodhimi i brendshëm përfaqësohet kryesisht nga eksporte në metale (ferrokrom dhe alumin), lëkurë e papërpunuar, lëndë drusore, bimë medicinale, produkte minerale dhe duhan. Efektin më të madh në rënien e të ardhurave nga eksporti i prodhimit të brendshëm e dha rënia e eksporteve në ferrokrom dhe alumin.

**Tabelë 4. EKSPORTI SIPAS 21 GRUPMALLRAVE (në milionë usd).**

HS	GRUPMALLRA	Volumi (në mln USD)			Pesha (%)			Ndryshimi (%)	
		T2 2001	T1 2002	T2 2002	T2 2001	T1 2002	T2 2002	T2 2002/T1 2002	T2 2002/T2 2001
I	Kafshët e gjalla; Produktet me origjinë kafshore	0.9	0.2	0.9	1.0	0.3	1.2	248.1	0.4
II	Produktet vegjetale	2.0	2.7	2.3	2.3	3.6	3.2	-13.8	17.5
III	Vajra dhe yndyra kafshore apo vegjetale	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	...	...
IV	Ushqime të përgatitura, pije alkoolike e uthull, duhan	2.8	0.7	1.9	3.2	0.9	2.7	178.5	-32.9
V	Produkte minerale	1.5	1.4	2.1	1.8	1.8	3.0	53.7	39.0
VI	Produktet e industrisë kimike apo ind. të lidhjeve	0.8	0.3	0.4	1.0	0.4	0.6	38.0	-50.9
VII	Plastikat; gomat dhe artikujt e tyre	0.2	0.2	0.1	0.2	0.3	0.1	-55.3	-46.0
VIII	Lëkurat e papërpunuara e të përpunuara, artikujt e tyre	3.3	3.1	3.2	3.7	4.1	4.4	3.5	-2.6
IX	Druri, tapa art. e tyre; prodhime kashte, kallama	1.9	2.2	2.2	2.1	2.9	3.0	-2.1	14.8
X	Brumi i drurit, mbetjet e letrës, letra, kartoni art. të tyre	0.5	0.5	0.3	0.6	0.6	0.5	-30.6	-31.4
XI	Tekstilët dhe artikujt tekstilë	28.4	32.2	26.0	32.3	42.3	36.1	-19.1	-8.3
XII	Veshjet e këmbëve, të kokës, cadrat, lule artificiale	26.5	22.6	20.7	30.2	29.7	28.7	-8.3	-22.0
XIII	Art. prej guri, alicie, cimentoje; qeramike; qelq	0.5	0.7	0.3	0.6	0.9	0.5	-46.9	-34.4
XIV	Perlat; gurë e metalet e cmuar; bizhuteri; monella	4.3	0.1	0.1	4.9	0.1	0.1	33.9	-98.0
XV	Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	8.2	6.7	6.7	9.4	8.8	9.3	-0.3	-19.0
XVI	Makinieri e pajisje mekanike, elektrike, pjesët e tyre	3.6	1.1	3.3	4.1	1.4	4.5	204.9	-10.3
XVII	Mjete transporti, avjone, anije, pajisje shoqëruese transp.	0.6	0.3	0.2	0.7	0.4	0.3	-22.7	-67.3
XVIII	Instrumente e aparate optike; orë; instrum. Muzikorë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	70.9	111.1
XIX	Armët e municione; pjesët e plotësuesit e tyre	0.0	0.1	0.0	0.0	0.1	0.0	-84.4	-61.3
XX	Artikujt të ndryshëm të prodhuar	1.6	1.1	1.4	1.9	1.4	1.9	23.2	-17.2
XXI	Veprat e artit, copat e mbledhura nga antikikat	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	...	...
<b>TOTALI</b>		<b>87.8</b>	<b>76.0</b>	<b>72.1</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>-5.1</b>	<b>-17.9</b>

Edhe pse në rritje krahasuar me tremujorin e dytë të vitit të kaluar (rritje rreth 2 herë), eksporti i duhanit i pakësuar për shkak të rënies së prodhimtarisë së tij përgjatë vitit 2001 (si pasojë e faktorëve natyrorë), mbetet ende nën kuotat e regjistruara në vite.

Eksporti në bimë medicinale vlerësohet në rritje, rreth 10 për qind, ndaj tremujorit të dytë të vitit 2001.

Ecuria e eksporteve është e varur nga zhvillimet në industrinë e përpunimit aktiv në vend, eksportet e të cilës përfaqësojnë në mëse 73 për qind volumin e përgjithshëm të eksporteve. Situata e vështirë energjitime mendojmë të ketë patur efektin e saj në rënien e eksportit nga industria e përpunimit me material porositësi.

### 2.1.3 Partnerët tregtarë

Bashkimi European mbetet partneri më i madh tregtar për Shqipërinë. Mëse 78 për qind e transaksioneve tregtare, në tremujorin e dytë të vitit 2002, u zhvilluan me vendet e BE-së, duke regjistruar rritje të volumin tregtar të mallrave (5 për qind) krahasuar me periudhën korresponduese të një viti më parë.

Intensifikimi i shkëmbimeve tregtare me këtë grupim vërehet vetëm në krahun e importeve, të cilat u vlerësuan 7 për qind më të larta kundrejt periudhës korresponduese në vitin paraardhës, ndërkohë që, eksportet shqiptare mbeten akoma larg pozitive kompetitive në tregjet e BE-së. Të ardhurat nga eksporti, me këtë grupim, ranë me rreth 13 për qind.

Periudha të cilën po analizojmë nuk sollli ndryshime përsa i përket gjeografisë së tregisë së jashtme. Aktiviteti tregtar i Shqipërisë mbetet i përqendruar në shkëmbime mallrash me dy shtete europiane, Italinë dhe Greqinë. Mëse 65 për qind e volumit të përgjithshëm të transaksioneve tregtare të vendit, gjatë këtij tremujori, u kryen me këto dy shtete, përkatësisht 42 për qind me Italinë dhe 23 për qind me Greqinë.

Rreth 54 për qind të transaksioneve tregtare me grupimin e BE-së, këtë tremujor janë kryer me Italinë. Tregtia me Italinë vlerësohet në rritje, rreth 5 për qind krahasuar me tremujorin e dytë të vitit të kaluar. Tregtia me Italinë njohu rritje në importe (14 për qind). Kërkesa për importe nga ky vend ishte e përqendruar kryesisht në makineri e pajisje elektrike, këpucë, artikuj të veshjes, lëkurë, mallra ushqimorë, çimento, fruta, artikuj gizë e çeliku (shih grafikun 6).


Italia përfaqëson tregun e parë për eksportet shqiptare. Eksporti me këtë vend realizoi 73 për qind të të ardhuarve në valutë nga aktiviteti tregtar i vendit. Në rolin e investitorit kryesor në industrinë lehtë të përpunimit në vend, eksportet kryesore me Italinë ishin kryesisht rieksperte në produkte mall me porosi (tekstile, këpucë dhe artikuj prej metali), rënia e të cilave çoi në rënie të eksporteve për këtë periudhë me rreth 17 për qind.

Aktiviteti tregtar me Greqinë vlerësohet rreth të njëjtit nivel të regjistruar në periudhën korresponduese të një viti më parë. Importi i mallrave vlerësohet lehtë në rënie (rreth 1 për qind), ndërkohë që, në eksporte u regjistruan rritje (rreth 7 për qind). Shpenzimet në importe me Greqinë përfaqësojnë 25 për qind të

shpenzimeve totale për importe dhe kanë qenë kryesisht për importe në karburante, makineri e pajisje, duhan, produkte të industrisë bluajtëse, artikuj të veshjes, gizë e çelik, çimento, artikuj plastikë dhe fruta.

Produktet kryesore që kanë gjetur treg në vendin fqinj ishin kryesisht artikuj tekstilë (të prodhuar me porosi), druri dhe artikujt e tij, duhan, bimë medicinale, periodikë (botime) dhe karburante, duke kontribuar në masën 12 për qind në të ardhurat nga eksporti i mallrave.

**GRAFIK 6. TREGTIA NË MALLRA ME PARTNERËT KRYESORË (në milionë dollarë).**



Tregtia me vendet e Rajonit<sup>5</sup> zë rreth 15 për qind të totalit të shkëmbimeve tregtare të Shqipërisë me botën. Këtë tremujor, tregtia në rajon prezantohet me 17 për qind të volumit të importuar dhe 8 për qind të volumit eksportuar. Në importe shkëmbimet tregtare kryhen në masën më të madhe me Turqinë, Kroacinë dhe Bullgarinë.

Në eksporte tregtia zhvillohet kryesisht me Maqedoninë dhe me Republikën Jugosllave (përfshihet Mali i Zi dhe Kosova).

Në kuadrin e nënshkrimit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë mes vendeve të Europës Juglindore<sup>6</sup>, pritet në të ardhmen një intensifikim i shkëmbimet tregtare të Shqipërisë me vendet e rajonit. Marrëveshjet dypalëshe të tregtisë së lirë me vendet e Ballkanit janë ndër prioritetet kryesore të vendit. Këto marrëveshje përfshijnë liberalizimin e tregtisë së ndërsjelltë përgjatë një periudhe tranzicioni prej 6 vjetësh. Gjatë kësaj periudhe rreth 90 për qind e tregtisë do të liberalizohet. Shqipëria ka tashmë marrëveshje të tregtisë së lirë me Maqedoninë, Kroacinë<sup>7</sup> si dhe negociata në proces me Bosnje-Hercegovinën, me Jugosllavinë, Malin e Zi, Bullgarinë, Rumaninë dhe Moldavinë.

Shkëmbimet tregtare me Turqinë, e cila është konsoliduar tashmë si partneri i tretë i Shqipërisë në aktivitetin tregtar me botën, përfaqësojnë 5 për qind të volumit të përgjithshëm të transaksioneve tregtare të zhvilluara përgjatë këtij tremujori. Tregtia me Turqinë u vlerësuar 9 për qind më e lartë krahasuar me periudhën korresponduese në vitin paraardhës. Aktiviteti tregtar zhvillohet gjerësisht në krahun e importeve, ndërkohë që, eksportet shqiptare nuk kanë gjetur treg në këtë vend. Turqia është investitor në metalurgjinë e përpunimit të metaleve në vend (Kurum Elbasan). Kështu që, në masë të konsiderueshme importohet lëndë e parë në gjysmë produkte gize e çeliku.

---

<sup>5</sup> Në këtë grupim përfshihen Bullgaria, Bosnia Hercegovina, Kroacia, Jugosllavia (përfshi Mali i Zi dhe Kosovë), Maqedonia, Rumania, Sllovenia dhe Turqia.

<sup>6</sup> Në kuadrin e Pakit të Stabilitetit është në proces nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe të tregtisë së lirë mes Shqipërisë, Bosnie-Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, Rumanisë, Moldavisë dhe Republikës Federale të Jugosllavisë, që gradualisht do të plotësohen brenda fundit të këtij viti.


<sup>7</sup> Marrëveshja e Tregtisë së Lirë mes Shqipërisë dhe Maqedonisë është aplikuar nga 1 gushti i vitit 2002, dhe ajo me Kroacinë është nënshkruar dhe pritet të ratifikohet nga Kuvendi i Shqipërisë.



## 2.2 SHËRBIMET

Transaksionet e shërbimeve regjistruan një volum prej rreth 267 milionë dollarësh. Ky volum vlerësohet rreth 21 dhe 26 për qind më i lartë se ai i tremujorit të parë të vitit dhe i të njëjtës periudhë një vit më parë. Kjo rritje i dedikohet kryesisht importit të shërbimeve, i pasuar nga eksporti i kësaj kategorie. Kështu importi i shërbimeve regjistroi rreth 148 milionë dollarë dhe vlerësohet i rritur me rreth 33 për qind kundrejt tremujorit paraardhës dhe rreth 42 për qind kundrejt tremujorit të dytë të vitit 2001. Kjo rritje e dukshme ka ardhur si rezultat i rritjes së madhe të shpenzimeve të turizmit, të cilat zunë rreth 62.3 për qind të importeve të shërbimeve. Këtë tremujor, shqiptarët kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 92 milionë dollarë amerikanë ose rreth 1.6 herë më shumë se në tremujorin korrespondues të vitit paraardhës dhe rreth 1.4 herë kundrejt tremujorit paraardhës.

**Grafik 5. BILANCI I SHËRBIMEVE.**



Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të shqiptarëve që kanë udhëtuar jashtë ashtu edhe rritjes së shpenzimeve ditore për turist, megjithëse numri i ditëqëndrimit ka pësuar rënie<sup>8</sup>.

<sup>8</sup> Sipas rezultateve të vrojtimit që kryen Banka e Shqipërisë për turizmin.

Ashtu siç pritej, rritja e vëllimit të importit ka shkatuar rritjen e importit të shërbimeve të transportit të mallrave me rreth 37 për qind kundrejt tremujorit të parë të vitit dhe rreth 29 për qind kundrejt tremujorit të dytë të vitit 2001.

Eksporti i shërbimeve gjatë tremujorit të dytë të vitit regjistroi rreth 120 milionë dollarë dhe vlerësohet rreth 10 për qind më i lartë si kundrejt tremujorit paraardhës ashtu edhe atij të njëjtë një vit më parë. Kjo rritje i dedikohet rritjes së të ardhurave nga aktiviteti i turizmit, të cilat zënë 79 për qind të eksporteve të shërbimeve dhe vlerësohen rreth 94.5 milionë dollarë, shifër kjo rreth 6 dhe 2 për qind më e lartë se ajo e tremujorit të parë dhe tremujorit të dytë të vitit të kaluar. Megjithëse numri i turistëve dhe ditëqëndrimi mesatar i tyre në Shqipëri kanë pësuar një rritje të lehtë vihet re një rënie e ndjeshme e shpenzimeve ditore për turist.

Kategoria “shërbime të tjera” ka regjistruar një suficit prej 9 milionë dollarësh dhe vlerësohet me një rritje rreth 3 herë kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë. Kjo rritje vërehet kryesisht në bilancin e shërbimeve të komunikacionit. Megjithatë, roli i tyre në zhvillimet e tregtisë së shërbimeve vazhdon të mbetet modest dhe pa ndonjë ndikim të dukshëm.

### **2.3 TË ARDHURAT**

Bilanci pozitiv i të ardhurave gjatë tremujorit të parë regjistroi 26.2 milionë dollarë. Ky suficit përfaqëson rreth 70 për qind të tremujorit të dytë të vitit 2001 dhe vlerësohet në rënie prej rreth 8 për qind kundrejt tremujorit paraardhës.


Të ardhurat nga puna e punëtorëve sezonalë, këtë tremujor (22 milionë dollarë) regjistruan një rritje prej 11.5 për qind kundrejt atij korrespondues të vitit të kaluar dhe 17 për qind kundrejt tremujorit paraardhës. Të ardhurat nga investimet e mjeteve valutore të sistemit bankar regjistrojnë rreth 13.7 milionë dollarë dhe megjithëse vihet re një rritje nga tremujori paraardhës, këto të ardhura kanë pësuar një rënie prej 30 për qind, si rrjedhojë kjo e rënies së depozitave tona në bankat dhe në institucionet e huaja jorezidente.

Ndërkohë, të ardhurat e dala jashtë në formën e interesave të paguar për depozitat e jorezidentëve në sistemin tonë bankar si dhe interesave të borxhit të jashtëm, regjistrojnë 8.6 milionë dollarë.

## 2.4 TRANSFERTAT

Bilanci i transfertave korente, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2002, regjistroi 134 milionë dollarë. Këto transferta kanë mbuluar rreth 47 për qind të deficitit tregtar. Të ardhurat nga emigrantët, të cilat zënë peshën kryesore në transfertat korente këtë tremujor regjistruan rreth 124 milionë dollarë. Krahasuar me tremujorin e parë vihet re një rënie e këtyre dërgesave pasi ka rënë edhe fluksi i parave në formën e monedhave të nënfishave të Euros për t'u konvertuar. Megjithatë, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2001 këto dërgesa janë rritur me 11.6 për qind dhe vlerësohen rreth 11.5 për qind më të larta se ato të tremujorit të dytë të vitit paraardhës.

**Grafik 6. STRUKTURA E TRANSFERTAVE .**



Transfertat shtetërore (9.7 milionë dollarë) këtë tremujor dominohen kryesisht nga transfertat në asistencë teknike (68 për qind) dhe nga ndihmat mallra (32 për

qind). Rritja e transfertave korente është shoqëruar, gjithashtu, nga rritja e transfertave kapitale.


## 2. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Tremujori i dytë i vitit regjistroi një fluks neto kapitalesh prej 91 milionë dollarësh. Transfertat e kapitalit regjistrojnë rreth 37.5 milionë dollarë, ndërkohë llogaria financiare paraqitet me një fluks kapitalesh neto prej 53.6 milionë dhe vlerësohet në rritje kundrejt periudhës korresponduese të vitit 2001. Kjo rritje vjen si rrjedhojë e rënies së mjeteve tona jashtë.

### 3.2 DETYRIMET FINANCIARE

Detyrimet financiare gjatë tremujorit të dytë të vitit 2002 u rritën me rreth 38 milionë dollarë. Kjo rritje vlerësohet 28 për qind më e lartë se ajo e tremujorit paraardhës dhe rreth 23.8 për qind më e ulët se e tremujorit të dytë të vitit 2001.

**Grafik 7. FLUKSET FINANCIARE (në mln usd).**




Rritja e detyrimeve financiare përfaqësohet kryesisht në formën e investimeve të huaja direkte, të huamarrjes së linjave të kredive të huaja ndërkohë që depozitat e sistemit bankar në bankat dhe në institucionet jorezidente paraqiten në rënie.

*Investimet e huaja direkte* gjatë tremujorit të parë regjistruan një fluks prej 29 milionë dollarësh dhe vlerësohen rreth 38 për qind më të larta se tremujori paraardhës ndërkohë që, krahasur me të njëjtën periudhë një vit më parë këto vlerësohen rreth 12 për qind më të ulëta. Megjithatë, këto flukse kapitali mbeten një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare.

*Huamarrja.* Kapitaleve të investuara në formën e investimeve direkte i janë shtuar dhe disbursimet e kredive të huaja. Tremujori i dytë regjistroi 15.7 milionë dollarë disbursime, të cilat zënë rreth 64.5 për qind të atyre të periudhës korresponduese të vitit 2001.

**Grafik 8. DETYRIMET NDAJ KREDITORËVE TË HUAJ.**



Disbursimet kanë shkuar me rreth 96 për qind në favor të sektorit “Qeveria e Përgjithshme” dhe përfaqësojnë rritjen e detyrimeve të këtij sektori dhe rreth 4 për qind kanë shkuar në favor të sektorit “Autoritet Monetar”. Këto disbursime përfaqësohen kryesisht nga kreditë e Bankës Botërore nëpërmjet Agjencisë së Zhvillimit (IDA).

Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit regjistruan rreth 10 milionë dollarë.

Detyrimet financiare në formën e *depozitave të jorezidentëve* në sistemin bankar, për tremujorin e dytë të vitit 2002 kanë rënë me 7.4 milionë dollarë amerikanë duke arritur shifrën 77.7 milionë dollarë. Kjo rënie është rreth 1.8 herë më e madhe se ajo që përsuan këto depozita në tremujorin e dytë të vitit 2001, ndërkohë që në tremujorin e parë 2002, këto shfaqeshin në rritje. Muaji prill shënoi shifrën më të ulët të këtyre depozitave përgjatë gjithë tremujorit të dytë të vitit 2002 me rreth 76 milionë dollarë.

Edhe gjatë këtij tremujori depozitat në *euro* vazhdojnë të kenë peshën kryesore me 74 për qind, pasuar nga ato në *usd* e *chf* përkatësisht me 20 e 4 për qind.

### **3.2 MJETET FINANCIARE**

Mjetet tona financiare regjistruan një rënie prej 16 milionë dollarësh. Kjo rënie erdhi kryesisht si pasojë e rënies së depozitave të sistemit bankar në bankat dhe institucionet financiare jashtë. Kështu, në fund të tremujorit këto depozita regjistrojnë një rënie prej 35 milionësh dollarë në ndryshim nga rritja prej rreth 3 milionë dollarësh që kishin pasur ato në tremujorin e parë. Stoku i depozitave jashtë në fund të këtij tremujori është 5.6 për qind më i ulët se në fund të tremujorit të parë të vitit 2002 dhe 2.2 për qind më i lartë se në fund të tremujorit të dytë të vitit 2001. Rënia e depozitave të sistemit tone bankar jashtë të muajit mars u shoqëruan nga shifra akoma më të ulëta në prill, muaj i cili shënon vlerën më të ulët përgjatë tremujorit (rreth 388 milionë dollarë). Kjo rënie vjen edhe për shkak të rënies së depozitave të rezidentëve në sistemin tonë bankar si pasojë e tërheqjeve të depozitave nga individët shqiptarë pranë bankave të nivelit të dytë gjatë marsit.


Depozitat e rezidentëve jashtë gjatë tremujorit përbëhen nga ato në *usd* me 54 për qind e në *euro* me 45 për qind që do të thotë që raporti ka vazhduar të ndryshojë në favor të depozitave në *euro*.

Investimet e portofolit këtë tremujor janë rritur me 10 milionë dollarë. Kjo rritje është rreth 1.6 herë më e lartë se periudha korresponduese një vit më parë.

### 3. REZERVAT

Rezervat e autoritetit monetar, në tremujorin e dytë të këtij viti, u rritën me rreth 1 milion dollarë. Kjo rritje është regjistruar kryesisht në zotërimet në SDR, me rreth 1.2 milionë dollarë ndërkohë që, vihet re një rënie prej 0.3 milionë dollarësh pasi këto mjete valutore janë përdorur për shlyerjen e borxhit të jashtëm pjesë e autoritetit monetar.

**Grafik 9. REZERVAT E AUTORITETIT MONETAR.**



Niveli i rezervave valutore në fund të tremujorit të dytë të vitit, 787 milionë dollarë, ishte i mjaftueshëm për të përballuar 6.5 muaj importe (import mallrash).